




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Nr. Prot.	2-D/DPK	01-4286/13	
Udh. / Bf Prot.			
Udh. / Prot. No.			
Udh. / Data	02	16.12.2013	
Udh. / Datum			
Udh. / Date			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.12.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3538/13, për z. Naser Lajqi – Prodekan në Fakultetin e Inxhinjerise Mekanike në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti nr. AKK-03-3538-13, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, z. Naser Lajqi – Prodekan në Fakultetin e Inxhinjerisë Mekanike në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në disa biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3538/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z.Lajqi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit(AKK) pas të cilës ai është paraqitur në AKK, duke sjellur me vete ndryshimet e bëra në biznesin privat në të cilin deri në këtë kohë ka pas edhe funksionin e personit te autorizuar.

Zyrtari i lartë, z.Lajqi në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPK/DPKI-03-4189/13), në të cilën shihet se ai e ka hequr dore nga funksioni i personit te autorizuar te biznesi privat N.Sh. “Proeks” duke e emruar këtu një person të besuar, në mënyrë që ai vet të ushtroj vetëm funksionin e vet zyrtar si Prodekan në Fakultetin e Inxhinjerisë Mekanike në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

